

MIGRIMI I PROFESIONISTËVE JASHTË VENDIT- VLERËSIM I
SHKURTËR SOCIOLOGJIK

TEMA PËR TITULLIN

MASTER I SHKENCAVE NË SOCIOLOGJI – DREJTIMI

ARSIMOR

nga

BEHAR OSMANI



UNIVERISTETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I SOCIOLOGJISË

PRISHTINË

KORRIK, 2022

MIGRIMI I PROFESIONISTËVE JASHTË VENDIT- VLERËSIM I SHKURTËR SOCIOLOGJIK

Mentor: Prof. Ass. Dr. Gëzim Selaci

Kandidati: Behar Osmani

Punimi “Migrimi i profesionistëve jashtë vendit- vlerësim i shkurtër sociologjik” mbrohet nga Behar Osmani për marrjen e gradës Master në Sociologji.

Qëllimi kryesor i këtij studimi është që të trajtohet ky fenomen në perspektivën sociologjike duke vlerësuar shkurtimisht zanafillën e dukurisë së migrimit të kuadrove, zhvillimin e tij dhe projeksionet e mundshme të ardhshme të tij.

Metodologjia e punës:

Në studimin e fenomenit Migrimi i profesionistëve jashtë vendit- është vlerësim i shkurtër sociologjik, metodologjikisht si qasje është përshkrues, observues, analizues dhe interpretues. Fenomeni i “migrimit të profesionistëve jashtë vendit” matet edhe empirikisht. Metoda kualitative është qasja metodologjike kryesore e përshtatshme për këtë studim. Instrumenti për të arritur të gjeturat është intervista e gjysëm strukturuar, e cila përmban dhjetë (10) pyetje. Mostra që përdoret në këtë studim është e qëllimshme dhe për target ka kuadrot që kanë migruar për në vendet perëndimore apo edhe në një mënyrë tjetër edhe atë (kuadër) që është në planifikim e sipër për të migruar, numri i të cilëve është dhjetë (10).

Punimi nisët nga këto pyetje hulumtuese:

1. Si shpjegohet dukuria e migrimit të profesionistëve?
2. Cilat janë arsyet kryesore të migrimit të kuadrove jashtë vendit?
3. Çfarë do të duhej të bënin institucionet rrethë dukurisë së migrimit të kuadrove jashtë vendit?
4. Çfarë konsekuencash mund të prodhojë “*ikja e trurit intelektual*”?
5. A mund të parashihet rikthimi i kuadrove në vend?

Hipoteza kryesore:

Mosndërlidhja mes sistemit të arsimit dhe tregut të punës krijon një hendek në këto dy fusha dhe shoqëror në përgjithësi. Sa më shumë të zgjasë kjo mosndërlidhje thellimi i hendekut bëhet më i madh. Ndonëse kjo gjendje e mos përputhshmërisë krijon edhe destabilitet shoqëror të brendshëm e shpërfaqë edhe dukurinë e migrimit. Masa e saj më e prekshme në një shoqëri është ajo e formuar në aspektin arsimor. Në një shoqëri çfarë jemi edhe ne, me një demokraci të brishtë, fenomeni *brain drain* duket të jetë aty i pranishëm.

Struktura e këtij punimi është e ndarë në katër kapituj:

Pjesa e parë e studimit do të përmbajë pjesën teorike (*konceptet themelore*) ajo se çka është migrimi dhe çka është integrimi, si dhe mendimet e teoricienëve të sociologjisë prej klasicizmit e modernizmit e deri të konceptet postmoderniste. Njohja e nocionit migrim dhe integrim, para se gjithash e bën më të lehtë qasjen në studim, pasi përmes tyre kuptohet vija ndarëse, shto këtu edhe ruajtjen e identitetit nga emigranti në vendin integrues. Njohja e saktë e tyre do të jetë imanente për zbërthimin e tekstit, pasi që shpeshherë brenda kapitujve do të kemi denduri të madhe të informacioneve.

Ne *pjesin e dytë* të këtij studimi skicohet fenomeni i ikjes së kuadrove, analizohet situata politike dhe socio-ekonomike duke përfshirë edhe at kulturore dhe demografike dhe pikepamje të tjera që kontribuojnë në identifikimin e dukurisë së ikjes së kuadrove nga vendi.

Pjesa e tretë shtrihet në rrafshin praktik. Së pari identifikohen dhe pastaj listohen top faktorët me determinues të migrimit të kuadrove nga kendveshtrimi që ata jepen. Të gjeturat nga tereni janë pjesë e fuqishme reprezentative e këtij studimi dhe në saje të tyre vlerësohet shkurtimisht fenomeni i migrimit të kuadrove jashtë vendit nga prizmi sociologjik. Pjesë e këtij kapitulli janë edhe statistikat si shtesë integruese.

Pjesa e katërt dhe e fundit në këtë studim është pjesë analizuese. Në këtë pjesën e katërt hedhet dritë edhe mbi pasojat e dukurisë së ikjes së kuadrove jashtë vendit. Analizat janë rekomanduese dhe theksi vihet si kritikë në atë se çfarë do të duhej të bëhej ndryshe në raport me ikjen e "*trurit intelektual*". Po ashtu krejt në fund si shtesë plotësuese diskutohet si analizë edhe mundësia e rikthimit të kuadrove në vend, qoftë ai i pjesshëm, apo i përhershëm si potencial kontributdhënës.

